

PARTIA

“REPUBLIKANE SHQIPTARE”

TIRANE

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE REGJISTRUAR

Per Auditimin Ligjor

të Fondeve të përfituara dhe Shpenzimet e Kryera

për Fushatën Zgjedhore 2013

Tirane,me 18 Tetor 2013

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU

Drejtuar : -Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

(Pallati i Kongreseve)

Tirane

- Partia Republikane

(Rr."Abdi Toptani" ish hotel Drini,kt.3)

Tirane

Te Nderuar Zoterinj:

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor i RSH"i ndryshuar, ne zbatim te Vendimit te KQZ Nr. 752 date 02/08/2013 si dhe Kontraten e Sherbimit Nr.6673 date 02/09/2013 te lidhur me kete institucion ne cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushaten zgjedhore, që fillon me datë 22.05.2013 me regjistrimin e Partisë Republikane në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 22.06.2013 me përfundimin e fushates zgjedhore të 23 Qershor të vitit 2013.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi mban pergjegjesi per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Ligjin Nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise" dhe Ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" date 29.04.2004. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazen e arketimeve dhe pagesave.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Ne çmojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Pasqyrat bashkëlidhur te fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë Republikane që fillon me date.22.05.2013 dhe mbyllet me daten 22.06.2013 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimeve dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Opinion

Sipas opinionit tone, bazuar ne auditimin e kryer,me siguri te aresyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare te fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë Republikane që fillon me date 22.05.2013 dhe mbyllet me daten 22.06.2013 jane përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimeve dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” duke dhene nje nje pamje te vertete dhe te sinqerte.

Per “LIRENG Auditing” Shpk

Neshat MAZE

Ekspert Kontabël i Regjistruar
Lic.148. date 21/07/2006

Tirane,me 18.10.2013

SHENIME MBI DEKLARIMET FINANCIARE

Deklarimet financiare te Partise Republikane Shqiptare qe i perkasin fondeve te siguruara dhe te shpenzuara per fushaten e zgjedhore per zgjedhjet per Kuvend 2013 perfshijne aktivitetin financiar kryesisht te periudhes 23 Maj- 23 Qershor 2013.

Bazuar ne auditimin e kryer,rezulton se te ardhurat jane evidentuar e deklaruar ne baze te arketimeve faktike,pa perfshire arketimet e pritshme,duke zbatuar rregullisht parimin kontabel te Kujdesit,nderkohe qe shpenzimet jane evidentuar e deklaruar ne perputhje me parimin kontabel te angazhimeve sipas te cilit,ato perfshijne te gjitha shpenzimet e kryera dhe te njohura pavareshisht ne se jane paguar apo mbeten per tu paguar ne periudha te mevonshme.Bazuar ne keto parime te kontabilitetit,ne llogarit kontabile e ne Pasqyrat Financiare te Partise Republikane jane evidentuar e deklaruar si shpenzime per fushaten zgjedhore edhe dy fatura te pranuar por te pa paguara per sherbimet e perfituara gjate fushates elektorale.Kjo menyre veprimi eshte ne perputhje te plote me kerkesat e ligjit Nr.9228,date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe me Standartet Kometare te Kontabilitetit te dala ne zbatim te tij.

Në këtë kuadër konceptual të të ardhurave e shpenzimeve , auditimi u shtri dhe mori në konsideratë edhe ngjarje e fakte ekonomike e financiare që i takojne fushatës zgjedhore të 23 Qershorit 2013, pavarësisht se ato kanë ndodhur edhe në periudha jashtë kufirit zyrtar të kësaj fushate e cili eshte 23 Maj - 23 Qershor 2013.

Auditimi i situatës financiare të fushatës zgjedhore të Partisë Republikane mori për bazë raportet financiare, regjistrat kontabile si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili na bëri të mundur krijimin e baze së opinionit të Audituesit të Pavarur për angazhime auditimi për qëllime të veçanta, në përputhje me SNA 800 , siç shpjegohet në vijim.

a- PER TE ARDHURAT

Bazuar ne auditimin e kryer rezulton se te ardhurat per fushaten elektorale te Partise Republikane,sipas burimit te financimit te tyre ,klasifikohen si vijon:

Nr	Burimet e Financimit	Sipas raportit financiar	Sipas auditimit	Diferenca	Pesha specifike
1	2	3	4	5	6
1	Nga buxheti i shtetit	7,578,576.00	7,578,576.00		89.91
2	Nga fondet e vet Partise Republikane				
3	Nga Donatoret(sponsorizime)	850,000.00	850,000.00		10.09
	-me banke				
	-me arke	850,000.00	850,000.00		
	-ne natyre				
	Gjithsej te ardhura	8,428,576.00	8,428,576.00		100.00

Nga auditimi rezultoi se të ardhurat e siguruar nga Partia Republikane për të përballuar fushatën e zgjedhjeve parlamentare 2013 janë deklaruar gjithsej 7,508,576 lekë. Këto të ardhura janë krijuar nga tre burime të ligjshme, dhe konkretisht:

1 – Financime nga buxheti i shtetit për fushatën elektorale. Partia Republikane Shqiptare ka perfituar fonde nga buxheti i shtetit 1,346,157.00 Leke siç parashikohet ne nenet 87 e ne vijim te Ligjit 10019 date 29/12/2008 i ndryshuar “Kodi Zgjedhor” per fushaten zgjedhore per Kuvend 2013, por nuk i jane xhiruar ne Llog Nr 029038601 te cilen e ka çelur per fushaten zgjedhore prane bankes Intesa Sanpaolo Bank ne pritje per t’u financuar.

2 – Fondet vjetore te akorduara nga buxheti i shtetit ne shumen 7,656,021.00 Leke me daten 23.04.2013 xhiruar ne llogarin bankare AL ...020290031801 Intesa Sanpaolo Bank. Një pjesë e ketyre fondeve, në shumën 7,578,576.00 Lekë është evidentuar dhe deklaruar si e ardhur ne Llog Nr 029038601 te fushates zgjedhore për të përballuar shpenzimet e fushatës elektorale për zgjedhjet e 23 Qershorit 2013, prandaj ky fond u përfshi në objektin tonë të auditimit

3.- Donacionet nga shtetas shqiptarë të ndryshëm, për shumen totale 850,000.00 Lekë përbëjnë burimin e tretë të krijimit të fondeve për fushatën zgjedhore te Partis Republikane duke zënë 11.32 % te fondeve gjithsej të siguruar për fushatën zgjedhore. Janë gjithsej 6 dhurues fondesh, shtetas shqiptarë të cilët kane sponsorizuar me shuma parash mbi 100.000.00 Lekë për çdo rast për fushatën elektorale të zgjedhjeve per zgjedhjet per Kuvendin 2013 si vijon:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Leke	Data e dhurimit	Llogarit ku jane derdhur parate
1	Ylli SHEHU	200,000.00	04.05.2013	Ne arke Ma Nr.10
2	Behare HASRAMA	100,000.00	18.05.2013	Ne arke Ma Nr.12
3	Namik KAMBERI	150,000.00	20.05.2013	Ne arke Ma Nr.13
4	Luan DUZHA	150,000.00	23.05.2013	Ne arke Ma Nr.14
5	Leonard ÇOTA	100,000.00	03.06.2013	Ne arke Ma Nr.16
6	Saimir HOXHAI	150,000.00	13.06.2013	Ne arke Ma Nr.18
	Shuma	850,000.00		

Nga verifikimi rezultoi se të gjithë dhuruesit kanë nënshkruar deklaratën e mospasjes konflikt interesi në përputhje me nenin 89 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Te gjithë këta dhurues janë evidentuar dhe deklaruar ne regjistrin e posaçëm , të mbajtur sipas formatit të miratuar me vendimin nr.266, datë 01.06.2009 nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Në të gjitha rastet dhurimet dhe perdorimet e tyre jane kryer nepermjet arkes se Partise,pa kaluar ne llogarine bankare te posaçme te hapur nga Partia Republikane.

b.- PËR SHPENZIMET

Nga verifikimet e kryera rezultoi se shpenzimet për fushatën elektorale të Partise Republikane,te grupuara sipas natyres se tyre jane si vijon:

LIRENG AUDITING SHPK
RAPORT AUDITIMI PER FONDET DHE SHPENZIMET

N r	Grupet e shpenzimeve	Shuma ne Leke	
		Sipas raportit financiar	Sipas auditimit
a	Shpenzime te paguara		
1	Reklama spote televizive	5,115,836.00	5,115,836.00
2	Pode me qera	346,000.00	346,000.00
3	Flamuj dhe aksesor	57,800.00	57,800.00
4	Karburant	103,000.00	103,000.00
5	Qera ambjentesh salla	1,666,740.00	1,666,740.00
6	Kancelari,leter,fotokopje(boje printeri. te #)	56,000.00	56,000.00
7	Foni dhe Ndriçim	910,000.00	910,000.00
8	Te ndryshme	173,200.00	173,200.00
	Shuma e shpenzimeve te paguara	8,428,576.00	8,428,576.00
b	Shpenzime te papaguara	11,140,000.00	11,140,000.00
1	Reklama televizive	11,140,000.00	11,140,000.00
	Shuma e shpenzimeve te papaguara	11,140,000.00	11,140,000.00
	Totali shpenzime	19,568,576.00	19,568,576.00

Shpenzimet e fushatës të Partise Republikane për zgjedhjet e 23 Qershorit 2013 janë deklaruar gjithsej 19,568,576.00 Leke, nga të cilat deri në datën e hartimit të këtij Raporti janë paguar 8,428,576.00 Leke (7,508,576.00 leke me arke dhe 920.000.00 Leke me banke) diferenca 11,140,000 lekë, ndonëse është njohur si shpenzim , nuk rezulton që të jetë paguar brenda kësaj periudhe.

Gjithashtu rezulton te gjitha pagesat e detyrimeve ndaj te treteve jane likujduar nepermjet arkes dhe jo nepermjet sistemit banker.Sugjerojme qe ne vazhdimesi detyrimet e prapambetura pa likujduara per mungesa fonde ne Shumen 11,140,000.00 Leke te kryhen nepermjet sistemit bankar.

Nga verifikimet tona rezulton se koha e kryerjes se ketyre shpenzimeve në përgjithësi përputhet me afatin zyrtar te fushatës zgjedhore, por një pjesë e tyre janë bërë para fillimit zyrtar të fushatës dhe një pjesë tjetër pas datës 23 Qershor 2013, në varësi nga koha e pranimit apo likujdimit të faturave për shërbimet e përfituara.Deklarimi i shpenzimeve eshte bere ne menyre korrekte.

Shpenzimet që, për shkak të mungesës së fondeve financiare, kanë mbetur pa u paguar përbëhen nga detyrime ndaj Top Channel dhe Media 6 (Tv Klan) te cilat kane kryer shërbime reklamash gjatë fushatës zgjedhore. Ky shërbime eshte i dokumentuar me fatura tatimore me tvsh konkretisht:

Nr	Subjekti	Fatura		
		Numer	Date	Shuma Leke
1	Top channel	09239729	22.06.2013	9,140,000.00
2	Tv Klan	09616220	30.09.2013	2,000,000.00
	Shuma			11,140,000.00

Në tërësi shpenzimet janë të dokumentuara me fatura tatimore apo mandat arkëtime të institucioneve buxhetore që nuk janë subjekte tatimore si dhe janë të evidentuara në pajtim me rregullat dhe standartet kontabile që zbatohen në Shqipëri.

Për të krijuar një opinion më të drejtë, krahas grupimit të deklaruar nga Partia Republikane, ne i riklasifikuam shpenzimet për fushatën e zgjedhjeve sipas natyrës së tyre, në 8 grupe shpenzimesh.

Ndryshimet në grupeve të veçanta të shpenzimeve janë pa efekte materiale në tërësinë e tyre dhe përfundimisht totali i shpenzimeve sipas auditimit është i barabartë me atë që ka deklaruar Partia Republikane. Shpenzimet të klasifikuara nga ana jonë janë si vijon :

1. Shpenzimet për Reklama televizive, 16,255,836.00 Lekë zëne pjesën kryesore ose 83% tyre. Nga këto 5,115,836.00 Lekë janë likujduar ndërsa diferenca 11,140,000.00 Lekë ka mbetur pa u paguar për mungesë fondesh duke u evidentuar e deklaruar në kontabilitetin e Partise si detyrime të kërkueshme nga furnitorët që do të shlyhen kur të sigurohen burime financimi.

Te detajuara sipas subjekteve mediatike këto shpenzime përbëhen nga shërbime të kryera prej:

Nr.	Emertimi	Shuma Faturuar	Shuma Likujduar	Shuma Pa Likujduar
		Leke	Leke	Leke
1	Top-Channel	12,335,000.00	3,195,000.00	9,140,000.00
2	Tv Klan	2,000,000.00	-	2,000,000.00
3	Media Vizion Sha	682,500.00	682,500.00	-
4	Fokus Media News	1,238,336.00	1,238,336.00	-
	Shuma	16,255,836.00	5,115,836.00	11,140,000.00

Këto shpenzime janë kryer në bazë të kontratave të lidhura midis palëve dhe vërtetohen me fatura te rregullta tatimore.

Nga verifikimi rezultoi se të gjitha faturat e likujduara që i përkasin këtij grupi shpenzimesh jane paguar nepermjet llogarise se Arkes dhe vetem ne 1 rast nepermjet llogarive bankare.

2.-Shpenzime per pode me qera 346,000.00 Lekë. Nga verifikimi rezultoi se keto shpenzime vërtetohen me fatura tatimore dhe jane paguar nepermjet arkes.

3.-Shpenzimet për flamuj dhe aksesor 57,800.00 Leke, Nga verifikimi rezultoi se keto shpenzime vërtetohen me fatura tatimore dhe jane paguar nepermjet arkes.

4.- Shpenzimet per karburant 103,000.00 Leke përgjithësisht janë të dokumentuara me kupona tatimor kase, pagesa e te cilave eshte bere nepermjet llogarise se arkes.

5.- Shpenzimet per qera salla 1,66,740.00 Leke janë të dokumentuara me fatura tatimore dhe jane likujduar nepermjet arkes dhe bankes.

6.- Shpenzimet telefon 23,200.00 Leke nga verifikimi rezultoi se edhe këto shpenzime vërtetohen me dokumente me siguri të arsyeshme dhe janë likuiduar nëpërmjet llogaris se arkës.

7.- Shpenzimet për kanceleri(fletpalosje dhe Shtypshkrime) 56,000.00 Lekë , përbëhen kryesisht nga shpenzime per letër, bojë printeri, fotokopje, te cilat janë paguar nëpërmjet arkës. Nga verifikimi rezultoi se ato përgjithësisht janë të dokumentuara me fatura të rregullta tatimore.

8.- Shpenzimet për foni e ndricim 910,000.00 Lekë.Nga verifikimi rezultoi se ato përgjithësisht janë të dokumentuara me fatura të rregullta tatimore.

9.-Shpenzimeve te ndryshme 173,200.00 Lekë ku përfshihen shpenzime për koktej per mbyllje fushate.

Perfundimisht, bazuar ne auditimin e kryer, sipas Standartit Ndërkombetar të Auditimit Nr 800 (per qëllime të veçanta) me siguri të arsyeshme, në Raportin e Audituesit të Pavarur kemi shprehur opinionin se Pasqyra Financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve te Fushatës Elektorale të Partise Republikane jep një pamje të vërtetë e të sinqertë të të ardhurave të realizuara e të shpenzimeve të kryera gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet per Kuvend 2013.

Per “LIRENG Auditing” Shpk

Neshat MAZE

Ekspert Kontabël i Regjistruar
Lic.148. date 21/07/2006